

**Trepça Shoqëri Aksionare**  
**Trepça Joint Stock Companies**  
**Trepça Deoničarsko Društvo**

Mr. 875 Data. 23. 02-2022  
MITROVICË MITROVICË



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



## **RREGULLORE PËR SHPENZIMET E TELEFONAVE MOBIL NË TREPÇA SH.A**

Mitrovicë, më 16.02.2022

Në bazë të nenit 95 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 3 paragrafi 1.4 i Ligjit Nr.05/L-120 për Trepçën, Ligjit NR. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 20 të Ligjit nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 130 të Ligjit nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare dhe nenit 8 të Statutit të Trepça Sh.A, Bordi i Mbikëqyrës i Trepça Sh.A., në mbledhjen e mbajtur më 16.02.2022, miraton këtë:

## **RREGULLORE PËR SHPENZIMET E TELEFONAVE MOBIL NË TREPÇA SH.A**

### **Neni 1 Qëllimi**

1. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e shumës maksimale të shpenzimit të telefonis mobile në Ndërmarrjen Trepça Sh.A, si dhe procedurën e përdorimit të rregullt dhe efikas të telefonisë gjatë kryerjes së punëve dhe ushtrimit të përgjegjësiave nga punëtorët e ndërmarrjes.

### **Neni 2 E drejta për mbushje të telefonit**

1. Të drejtë për mbushje të telefonit mobil kanë si vijon:

1.1 Kryeshefi Ekzekutiv në shumën 20€

1.2 Zëvendës Kryeshefi Ekzekutiv 10€

1.3 Zytari Kryesor Financiar në shumën 10€

1.4 Sekretari Korporativ 10€

1.5 Zytari i Auditimit të Brendshëm 10€

1.6 Udhëheqësi i njësisë biznesore Miniera me Flotacion Trepça – Stan Tërg 10 €

1.7 Udhëheqësi i njësisë biznesore Miniera me Flotacion Kishinicë dhe Artanë 10 €

Sipas nevojave për punë Kryeshefi Ekzekutiv ka të drejtë aprovimi të shpenzimeve të telefonisë mobile edhe për ndonjë rastë të veçantë, pas aprovimit nga Bordi Mbikëqyrës i Trepça Sh.A.

### Neni 3

#### Tejkalimi i shpenzimeve

Tejkalimin e shpenzimeve telefonike të rregulluara me këtë rregullore mund ta aprovoj Bordi Mbikëqyrës i Trepça Sh.A, kur ai e vlerëson se tejkalimi i shpenzimeve është në funksion të realizimit të detyrave të punës, në të kundërtën tejkalimin e shpenzimeve mbi vlerën e përcaktuar me këtë rregullore e bartë vet punëtori i cili ka bërë tejkalimin.

### Neni 4

#### Dispozitat përfundimtare

Kjo Rregullore për shpenzimet e telefonave mobil në Trepça Sh.A, hynë në fuqi në ditën e aprovimit dhe fillon të aplikohet prej ditës së publikimit në webfaqen zyrtare.

Kryesuesi i Bordit Mbikëqyrës të Trepça Sh.A



Dr.Sc. Bahri Hyseni

